



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK VLORË

Nr. 159 Prot.

Vlorë, më 12 . 02 2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar: **DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”; të Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të Udhëzimit nr.759 datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,

Qendra e Formimit Profesional Publik Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Servis Xhenerik në automjetet e lehta” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Sipërmarrës dhe menaxher i biznesit të vogël” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Saldim” (me kohë të pjesshme);
- 1 (një) instruktor të praktikës profesionale në kursin “Aftësi Digjitale” (me kohë të pjesshme);

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet e të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Qendrës së Formimit Profesional Publik Vlorë, brenda datës 23.02.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTOR
ERGYS ALLIUSHI

